



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e IV-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr.49/11

Prishtinë, më 21.02.2012, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami dhe Albana Fetoshi.

Munguan: Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Muhamet Mustafa dhe Duda Balje.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Ramadan Islami, Juergen Schatz dhe Rejhane Zylfijaj, Njomza Ilazi nga GIZ, monitorues nga OSCE, KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i propozim amendamenteve të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.**
- 3. Shqyrtimi i propozim amendamenteve të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin nr. 04/L-80 për Lojërat e Fatit.**
- 4. Formimi i grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parasë dhe Financimit të Terrorizmit.**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri.

- 2. Shqyrtimi i propozim amendamenteve të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat**

Kryetarja, theksoi se ju e dini se me këtë projektligj parashihet bartja e kompetencave nga bordi i pavarur për rishqyrtime në Gjykatën Themelore të Prishtinës, ku në kuadër të kësaj gjykate parashihet të themelohet Divizioni Fiskal si shkallë e parë në shqyrtimin e ankesave tatimore, që është edhe esenca e ndryshimeve që janë bërë me këtë projektligj. Ne vazhdimisht kemi marr vërejtje nga komisioni evropian për mosefikasitetin dhe mosfunksionalitetin e këtij bordi në rishqyrtimin e ankesave tatimore. Grupi punues ka bërë disa ndryshime të nevojshme, ku janë qartësuar dispozitat e neneve të caktuara, janë bërë përmisimet teknike dhe gjuhësore, si dhe janë bërë harmonizimet me ligjin mbi gjykatat. Më pas kryetarja arsyetoi amendamentet e propozuara, të cilat amendamente u miratuan njëzëri.

Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Miratohen amendamentet e propozuara nga grupi punues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.
- II. Raporti me amendamente procedohet për miratim në procedurat e mëtutjeshme të Kuvendit.

3. Shqyrtimi i propozim amendamenteve të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin nr. 04/L-80 për Lojërat e Fatit

Kryetarja, theksoi se grupi punues ka punuar disa ditë në ndryshimet dhe plotësimet e mundshme të dispozitave të projektligjeve, që të jetë më i zbatueshëm në praktikë. Përgëzojë grupin punues për punën e tyre dhe amendamentet e propozuara para komisionit për miratim.

Hykmete Bajrami, njoftoi se si grup punues jemi përpjekur të punojmë shumë në amendamentimin e projektligjit dhe në takimet tona kanë qenë prezent përfaqësuesit e MF dhe ATK si dhe përfaqësuesit e Thesarit Amerikan. Janë propozuar 52 amendamentet, prej të cila 16 amendamente janë të deputetit Shaip Muja, pa përkrahje të grupit punues dhe 2 amendamente të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, po ashtu pa përkrahje të grupit punues. Arsyeja e mospranimit të amendamenteve z. Muja, ka qenë fakti se thelbi i tyre ka qenë licencimi i lojërave online. Për këtë çështje e kemi sugjerimet e ekspertit të Departmanetn amerikan që ka shprehur mendimin se në Kosovë nuk ka kushte për momentin për lojëra online. Ndër të tjera jemi munduar të vejmë kufizime të lojërave të afatit në afërsi të objekteve kulturore, fetare arsimore apo pronës komunale. Duke vlerësuar efektin negativ të lojërave, dhe duke ditur faktin se nuk mund të ndalohen, jemi munduar që përmes rregullave të kemi më shumë në kontroll. Për nenin 7 është lënë që të vendoset në komision. Ndërkaq në fillim kemi menduar të vëmë kufizime për shumat maksimale për slot mashinat, mirëpo përfaqësuesit e ATK-së, na kanë thënë se është teknikisht e pa implementueshme dhe e kemi lënë që kjo çështje të rregullohet me akt nënligjor.

Shaip Muja, theksoi se është keqinterpretuar propozimet e mija. Unë për sqarime duhet të them se nuk kam propozuar lojëra të reja online dhe kam thënë se nëse lejohen lojërat online duhet, të lejohen për kompanitë të cilat janë të licencuara në ATK dhe të iu nënshtrohen një kontrollit më të madh. Ndërsa nëse ndalohen, kjo duhet të ndodh për të gjithë dhe unë jam me propozimet që të ndalohen. Për maqinat e lojërave të fatit kam propozuar laboratorë të certifikuar në barrën e atyre që luajnë në lojërat e fatit të paguhen ata laboratorë dhe të certifikohen nga ministria e financave sipas standardeve ndërkombëtare për hardwer dhe për softuer. Në vazhdim arsyetoi amendamentet e propozuara nga ai.

Hykmete Bajrami, rikujtoi se në bazë të nenit 4, paragrafi 5 të projektligjit, ndalohen lojërat e fatit. Të gjithë amendamentet e deputetit muaj i kemi analizuar dhe diskutuar, madje edhe në praninë të tij që ka pasur rast të arsyetojë, si dhe në praninë e përfaqësuesve të ATK-së dhe MF-it dhe pas diskutimeve të gjata është vendosur që mos të përkrahen amendamentet. Nuk është qeshje se nuk i kemi kuptuar

propozimet dhe e kemi të qartë se nuk keni propozuar lojëra të reja por kërkesa juaj me i ndalues kompanitë që janë operojnë online në Kosovës është e pamundshme. Nuk mundesh me i thënë një kompanie psh. ipko ndaloju qytetarëve të Kosovës lojën online dhe nuk mundet të ndalohen me milion a webfaqe elektronike që ofrojnë lojëra online.

Shaip Muja, ripërsëriti se nuk ka kërkuar të lejohen lojërat online, por në rast se ato lejohen duhet kontrollohen dhe monitorohen përmes sistemit online. Lojërat elektronike duhet të certifikohen nga një laborator i cili është ndërkombëtarisht i pranuar.

Më pas filloj procedura e votimit të amendamenteve të propozuara:

Amendamentet 1 dhe 2 të propozuara nga grupi punues përkrahen njëzëri.

Amendamenti 3 i propozuar nga Deputeti Shaip Muja nuk përkrahet njëzëri nga komisioni.

Amendamenti 4 propozuar nga grupi punues përkrahet njëzëri.

Amendamenti 5 i propozuar nga Deputeti Shaip Muja nuk përkrahet njëzëri nga komisioni.

Naser Osmani, lidhur me nenin 7 që kanë të bëjë me lotarinë e Kosovës vlerësoj se nuk duhet të jetë me interes të veçantë për Kosovën. Propozoi që të bëhen ndryshimet në nenin 7 si në vijim:

Paragrafi 1, të riformulohet si në vijim: Lotaria e Kosovës është subjekt juridik-publik. Paragrafi 5, në rreshtin e dytë, pas fjalës “*fatit*” hiqet teksti, si në vijim: “dhe i lojërave për zbavitje”. Nënparagrafi 7.7 dhe paragrafi 8 të hiqen. Po ashtu propozoi që në nenin 8 paragrafi 2, në rreshtin e tretë fjala “4 (*katër*)-vjeçar”, zëvendësohet me fjalën “2 (dy)-vjeçar”.

Hykmete Bajrami, theksoi se mbështet plotësisht propozimet e z. Osmani dhe njoftoi se edhe ne në grupi punues na u është dukur konflikt interesi që lotaria e Kosovës të iu jepet një kompanie private që do të mund të ushtronte monopol në një treg të lirë dhe propozimet veç sa e pasurojnë nenin 7.

Ndryshime e propozuara nga deputeti Naser Osmani në nenin 7 dhe 8 miratohen njëzëri.

Amendamenti 7 i propozuar nga grupi punues përkrahet njëzëri.

Amendamenti 8 i propozuar nga Deputeti Shaip Muja përkrahet njëzëri nga komisionit.

Amendamentet 9, 10 dhe 11 të propozuara nga grupi punues përkrahen njëzëri.

Naser Osmani, për amendamentin 12 theksoi se mbështet propozimin e deputeti Muja, pasi që është e nevojshme sistemi i certifikuar ndërkombëtarisht për të shmangura manipulimet në certifikimin e lojërave të fatit.

Shaip Muja, ritheksoi se e kam specifikuar nevojën për certifikimin e softuerit nga laboratorët e pranuar ndërkombëtarisht, për të iu shmangur manipulimeve të mundshme.

Hykmete Bajrami, theksoi e kemi diskutuar këtë çështje me përfaqësuesit e ATK-së dhe arsyetimi i tyre ka qenë se ato do të certifikohen nga një kompani vendore që do të licencohet nga një kompani ndërkombëtare.

Latif Gashi, theksoi se nëse e pranojmë amendamentin e propozuar nga deputeti Shaip Muaj, duhet të themi për lojërat elektronike të lejuara me këtë ligj, për të shmangur mundësinë për referimin e lojërave online.

Hykmete Bajrami, theksoi se nëse pranohet amendamenti 12 duhet të pranohet edhe amendamenti 8, por se duhet të merret parasysh propozimi i deputetit Gashi për lojërat elektronike të lejuar me këtë ligj rishkruhen si: Për lojërat elektronike, të lejuara më këtë Ligj, sistemi duhet të jetë i certifikuar dhe i miratuar nga një laborator certifikues ndërkombëtar, që, si i tillë, është i identifikuar dhe i pranuar nga MF-ja.

Amendamenti 12, i propozuar nga Deputeti Shaip Muja përkrahet njëzëri nga komisioni.

Amendamenti 13, pranohet njëzëri propozimi i grupi punues, ndërsa refuzohet propozimi i Shaip Muja.

Amendamenti 14 i propozuar nga grupi punues përkrahet njëzëri nga komisioni .

Amendamenti 15 dhe 16 të propozuara nga Deputeti Shaip Muja nuk përkrahen njëzëri nga komisioni.

Amendamentet 17, 18 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30 të propozuara nga grupi punues përkrahen njëzëri.

Amendamenti 31, i propozuar nga Deputeti Shaip Muja nuk përkrahet njëzëri nga komisioni.

Amendamenti 32, pranohet njëzëri propozimi i grupi punues, ndërsa refuzohet propozimi i Shaip Muja.

Amendamentet 33, 34 dhe 35 të propozuar nga grupi punues përkrahen njëzëri nga komisioni .

Amendamentet 36, 37, 38 të propozuar nga Deputeti Shaip Muja nuk përkrahen njëzëri nga komisioni.

Naser Osmani, thekoi se mbështet amendamentin 39 që është propozuar nga Deputeti Shaip Muja.

Kryetarja, po ashtu mbështeti amendamentin 39 të propozuar nga Deputeti Shaip Muja.

Amendamenti 39 i propozuar nga Deputeti Shaip Muja përkrahet nga komisioni me pesë vota Për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi dhe Hasime Krasniqi), një Kundër (Hykmete Bajrami) dhe një Abstenim (Albana Fetoshi).

Amendamentet 40 dhe 41 të propozuar nga Deputeti Shaip Muja nuk përkrahen njëzëri nga komisioni.

Amendamentet 42, 43 dhe 44 të propozuar nga grupi punues përkrahen njëzëri nga komisioni.

Amendamenti 45, i propozuar nga Deputeti Shaip Muja nuk përkrahet njëzëri nga komisioni.

Amendamenti 46 përkrahet njëzëri propozimi i grupit punues, ndërsa refuzohet propozimi i Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të re.

Amendamentet 47, 48, 49, 50, 51 dhe 52 të propozuar nga grupi punues përkrahen njëzëri nga komisioni

Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Miratohen amendamentet e propozuara nga grupi punues për Projektligjin për Lojërat e Fatit.
- II. Raporti me amendamente procedohet për miratim në procedurat e mëtutjeshme të Kuvendit.

4 Formimi i grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parasë dhe Financimit të Terrorizmit

Kryetarja, theksoi e në planin e punës është paraparë që të monitorojmë dy ligj këtë. Në pjesën e parë të viti është planifikuar të monitorohet zbatimi i Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parasë dhe Financimit të Terrorizmit. Sipa strategjisë legjislative të qeverisë është paraparë që ky plotësimi dhe ndryshimi i këtij ligji. Do të ishte në interes që ta analizojmë monitorojmë zbatimin e këtij ligji para se te bëhen keto ndryshime dhe të procedohet në Kuvend për miratim.

Për grupin punues u caktuan këta deputetë: Xhevdet Neziraj – raportues, Jelena Bontic, Latif Gashi Albana Fetoshi dhe Hykmete Bajrami.

Kryetarja, lidhur me projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për TVSH-ne, i cili ka kaluar në lexim të parë në Kuvend, propozoi të formohet grupi punues për shqyrtimin e tij.

Për grupin punues u caktuan këta deputetë: Hasime Krasniqi – raportuese, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi dhe Duda Balje.

4.3. Kryetarja, njoftoi se nga dt. 28 shkurt deri më 1 mars 2012, do të jetë në një vizitë studimore në Çeki në bazë të ftesës që është bërë nga NDI.

Mbledhja përfundoi në orën 13:05.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj